ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Ndërmarrje Publike Lokale Përparimi SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **NPLP-24-2856-1-3-6** nr,brendshem

Sa i përket tenderit për "**Furnizim me kompresor ajri dhe aparat saldues**"

A N K E S Ë

1. Identifikimi i ankuesit*

ASDEK SHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Imzot Nik Prela , Hyrja II nr.10
(Adresa)

Prishtine — *(Vendi)*

10000 — *(Kodi postar)*

044/379812 — *(Numri Telefonit)*

n/a — *(Numri i Faks-it)*

Doruntina Kika
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

asdekshpk@gmail.com
(Adresa elektronike)

23.04.2024
(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

SH.P.K. ASDEK PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

ëShëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- *Njoftimi per kontrate 25.03.2024*
- *Njoftimi mbi vendimin e AK 12.04.2024*
- *Afati i fundit per dorezim te tenderit 04.04.2024 ne ora 13.00h*
- Kriteret e Dhenies se tenderit:Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më te ulët** ☒

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po X **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Me datë 16.04.2024 kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK. (Shtojce Kerkesa)
Me datë 16.04.2024 AK na kthen përgjigje duke e refuzuar kërkesën tonë dhe duke e lënë në fuqi vendimin e vet të marrur më herët. (Shtojce Pergjegjeja 16.04.2024). Arsyetimi i AK eshte se ne Dosjen e tenderit nuk eshte kerkuar KATALOG por vetem deklarate permbushje te specifikimeve teknike dhe deklarate per garancionin e produkteve
Të pa kënaqur me vendimin e AK për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim si te pabazuar në afat të rregullte kohorë parashtrojmë ankesë pran OSHP-së.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK gjatë zhvillimit te kësaj procedure ka shkelur këto dispozita të LPP dhe RRUOPP.

1. ***AK ka shkelur nenin 59 Ekz. Vler. dhe Krah. i Tenderëve të LPP të amandamentuar,***
2. ***AK ka shkelur nenin 28 Specifikimet teknike te LPP-se***
3. ***AK ka shkelur nenin 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi i LPP të amandamentuar***
4. ***AK ka shkelur nenin 1-Qellimi i LPP-se të amandamentuar***
5. ***Neni 10 UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK***

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

*Shoqëria ASDEK Shpk me seli në Prishtine (me tej: **Ankuesi**), brenda afatit ligjor te paraparë më dispozitën e Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 per Ankese, respektivisht, brenda afatit të lënë për Ankese paraqet këtë:*

ANKESË

per shkak te:

- *Konstatimit te gabuar te gjendjes faktike*
- *Aplikimit te gabuar te te drejtes materiale*

*Më të cilin Ankese **Ankuesi godet Njoftimin mbi Vendimimin e AK per shperblim me kontrate OE i cili eshte i papergjegjshme** dhe*

Propozon që

*Ankesen e paraqitur nga Ankuesi ta **MIRATOJ** si të bazuar në Ligj, **Vendimin per shperblim me kontrate ta ABROGOJ,** respektivisht, **ANULOJ** si dhe AK te vazhdon me tutje me proceduren e prokurimit per projektin e lartepermendur.*

Per te gjitha keto pretendime mbi shkeljet e komisionit vleresues kemi ofruar deshmi dhe argumente mbeshtetese te cilat i gjeni te bashkangjitura kesaj ankese. Bazuar ne kete konstatojme se komisioni vleresues perkatesisht AK nuk e ka respektuar nenin 59 te LPP-se me rastin e vlersimit, sqarimit dhe krahasimit te tendereve.
Pas gjithë këtyre sqarimeve, dhe fakteve të ofruara shpresojmë dhe besojmë se OSHP-ja do ta shqyrtoj me kujdes ankesën tonë kundër vendimit të AK-së dhe njëherit do ta aprovoj si të bazuar ankesen tone.

*Lidhur me aktivitetin e prokurimit: ""**Furnizim me kompresor ajri dhe aparat saldues**" me nr. te prokurimit **NPLP-24-2856-1-3-6** nr,brendshem..... pas kerkeses per Rishqyrtim me dt: 16.04.2024 kemi pranuar Vendimimin me daten 16.04.2024 nga AK ku refuzohet ne teresi si e pabazuar kerkesa per rishqyrtim dhe AK mbeshtet vendimin per te vazhduar lidhur me aktivitetin e prokurimit te lartepermendur.*
Pikat e Ankeses per shkeljet e pretenduara te Autoritetit Kontraktues jane te prezentuara si vijon:

- *Autoriteti Kontraktues, me daten 12.04.2024, nepermjet portalit E-prokurimi te KRPP-se,publikon Njoftimin mbi Vendimin per Njoftim per*

Dhenie te Kontrates per prokurimin:Furnizim me kompresor ajri dhe aparat saldues;

- *Kompania ASDEK Shpk , pas publikimit te Njoftimit mbi Vendim per Dhenie te Kontrates, me daten 16.04.2024, ka pergaditur dhe dorezuar Kerkesen per Ri-shqyrtim ne Autoritetin Kontraktues. Ne Kerkesen per Ri-shqyrtim, kemi listuar argumente dhe fakte te mjaftueshme ligjore qe Oferta e O.E te shpallur fitues nuk eshte Oferte e pergjegjeshme dhe nuk eshte ne pajtim me kerkesat, kushtet dhe kerkesat e Autoritetit Kontraktues.dhe ne kundershtim me Ankes 1 – specifikacionet teknike te detyrueshme*
- *Autoriteti Kontraktues, me daten 16.04.2024, ka dorezuar Vendimin per Refuzimin e Kerkeses per Rishqyrtim. Ne Vendimin per Refuzimin e Kerkeses per Rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues, jep arsyetime te pabazuara dhe te paargumentuara ne aspektin ligjor dhe teknik ngase mbeshtetet ne 'Vet –Deklaratë' te O.E te shpallur fitues per cilesine e produkteve kinse qe i plotesojne specifikacionet teknike te detyrueshme, edhe pse Autoriteti Kontraktues, nuk ka kerkuar ligjërisht 'Vet – Deklarata' te tilla me Dosje te Tenderit. Nga FDT neni III.4 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale "Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj deklaratë me shkrim për garancion të produkteve (aparat saldues - min.1 vit) - (kompresor të ajrit - min.6 muaj). Dëshmia e kërkuar dokumentare Deklaratë me shkrim e vulosur dhe e nënshkruar,**prandaj bazuar ne kete kerkese te nenit III.- te FDT askund nuk ka kerkuar deklarate per specifikacionet teknike si dhe te Aneksi 1 Specifikimet teknike te detyrueshme nuk ka kerkuar deklarate.***
- *Ne vendimin per refuzimin e Kerkeses per Rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues, nuk ka mundur te ofroje deshmi ligjore se O.E i shpallur fitues ka dorezuar oferten ne pajtim me dosjen e tenderit.*
- *Vleresimi i Ofertueseve behet 'eksluzivisht' kundrejt KERKESAVE TEKNIKE qe jane te specifikuara ne Fleten e te Dhenave te Dosjes se Tenderit dhe ne specifikacionet teknike te detyrueshme sipas Aneksit 1 por qe ne rastin konkret ky vleresim nuk eshte bere ne menyre ligjore dhe te drejte per OE te shpallur fitues pasi qe i njejti nuk i ka plotesuar kushtet dhe kriteret e dosjes se tenderit.*
- *Nese gjate procesit te vleresimit/Rivleresimit mungojne pershkrime te detajuara apo te qarta te produketeve te kerkuara ne Aneksin 1 Specifikat teknike te detyrueshme atehere duhet te eliminohet ofertuesi.*

Pas shiqimit te kopjeve te Ofertes se O.E te shpallur fitues 'INFINITT shpk ' konstatojme se ky O.E ka ofertuar ne kundershtim te plote me Dosjen e Tenderit te Aneks 1 te Dosjes se Tenderit per specifikimet teknike te detyrueshme.

Ne kete drejtim, ne asnje nen gjegjesisht dispozite ligjore te Dosjes se Tenderit por edhe me asnje Forme te prezentuar ne Dosje te Tenderit nuk

eshte kerkuar ligjerisht dhe ne menyre obligative ne aspektin ligjor nga Operatoret Ekonomik pjesemarres ***te leshojne 'VET DEKLARATE' qe produktet qe ofertojne per Furnizim me kompresor ajri dhe aparat saldues, i plotesojne specifikimet teknike te detyrueshme te*** *Aneks 1.*
Autoriteti Kontraktues, eshte dashur te bejne 'verifikim' te cilesise teknike te produkteve te ofruara, ashtu sic kerkohet me nenin 59 te Ligjit te Prokurimit Publik te Kosoves dhe Jo te mbeshteten ne 'vet – deklarata' te O.E te shpallur fitues se kinse produktet e tyre i plotesojne specifikimet teknik te detyrueshme dhe parametrat teknike te produkteve te ofertuar.
Prandaj, edhe 'Vet – Deklarata' e O.E te shpallur fitues 'INFINITT shpk' nuk eshte dashur te mirret ne konsiderate dhe te aprovojne si te ligjshme nga Autoriteti Kontraktues gjate procesit te vleresimit te ofertave ngase kjo 'Vet-Deklarate' nuk permbane asnje 'deshmi gjegjesisht prove'se keto produkte jane cilesore per nje furnizim cilesor per Klientin Ndërmarrje Publike Lokale Përparimi SH.A. dhe i permbajne ne teresi 'parametrat teknike' sipas pershkrimit teknik te potencuar ne Aneks 1 te specifikacioneve teknike te detyrueshme.
Ajo çka eshte e patolerueshme dhe indikative nga ana e AK gjegjeisht e komisionit vleresues se gjeja AK nuk ka kerkuar KATALOG por vetem deklarate permbushje te specifikimeve teknike (KJO NUK QENDRON –eshte e pavertete) dhe deklarate per garancion te produkteve. ***Deklarate per permbushje te specifimeve teknike AK nuk ka kerkuar ne FDT*** *ndersa te garancionit po. Prandaj bazuar edhe ne Kerkesen per Rishqyrtim edhe ne Ankesen qe jame duke shkruar per OSHP Autoriteti Kontraktues me sa di te lexoj shqip dhe te kuptoj shqip akund nuk ka kerkuar deklarate per specifikimet teknike por edhe me asnje Forme te prezentuar ne Dosje te Tenderit nuk eshte kerkuar ligjerishte dhe ne menyre obligative ne aspektin ligjor nga Operatori Ekonomik pjesemarres te leshojne "VET-DEKLARATE" qe produktet qe ofertojne per furnizim me aparat saldimi dhe komresor qe i plotesojne specifikat teknike te detyrueshme. Konstatimi i AK eshte i paqendrueshem dhe manipulativ.*
Ne baze te Nenit 10, i Udhezuesit nr.001/2023 per Prokurim Publik, ne tabelen e saj potencon se kur "Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu ("specifikimit teknik" – AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale të një produkti, ndërsa OE duhet të dorëzoj specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara. Përveç ne raste kur OE nuk mund të dorëzoj specifikimin teknik të një produkti të caktuar p.sh. peme/ përime etj. OE dorëzon deklaratën ku deklaron se mallrat do të jene ne përputhje" Si te veprohet? ***Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm neni 28 i LPP-se***
Nga ky ilustrim i potencuar ne tablen e nenit 10 te Udhezuesit Operativ 001/2023 konstatohet qarte qe VET-DEKLARATA per produktin/mallin e ofruar per Autoritetin Kontraktues nga O.E i shpallur fitues se kinse eshte ne pajtim me specifikacionet teknike nuk eshte dashur te mirrej parasysh dhe

eshte dashur te refuzohej Oferta menjehere nga Autoriteti Kontraktues duke e shpallur si Oferte plotesisht te pa-pergjegjeshme.
Me mos verifikimin dhe mos ekzaminim te 'produkteve' te ofruar nga O.E i shpallur fitues nga ana e anetareve te komisionit per vleresimin e ofertave, ashtu siç e kerkon neni 59 i Ligjit te Prokurimit por edhe sipas udhezimeve te dhena ne tabelen e nenit 10 te Udhezuesit Operativ 001/2023 per Prokurimit Publik, se a i ploteson Oferta teknike e O.E 'INFINITT SHPK ' specifikimet teknike te detyrueshme sipas Ankes 1 te Dosjes se Tenderit me 'parametrat teknike' te cekura me larte dhe ne vet Aneksin 1, Kompania Asdek shpk konstaton se Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje ligjore te nenit 59, 27 dhe 28 te Ligjit te Prokurimit Publik te Kosoves, por edhe te nenit 10 te Udhezuesit Operativ 001/2023 te Prokurimit Publik, nga se OE ka ofertuar ne kundershtim te plote me kushtet dhe kerkesat teknike dhe kerkesat ligjore te Autoritetit Kontraktues te prezentuara ne Aneks 1 te Dosjes se Tenderit.

Pretendimet tona ankimore, jane te njejta sikur qe jane te parashtruara ne Ankese ashtu kane qene te potencuara ne Kerkesen per Rishqyrtim.
Perfaqesuesit ligjor te Kompanise si parashtrues te Ankeses ne OSHP jane ne dispozicion qe sipas Rregullores se Punes se OSHP-se por edhe ne baze te nenit 108 / A te Ligjit te Prokurimit Publik te ofroje sqarime ligjore lidhur me permbajten e argumenteve tona dhe provave te potencuara ne Ankese para Ekspertit dhe Panelit Shqyrtues poqese kerkohen sqarime lidhur me permbatjen e Ankeses.
PERMBLEDHJE te pretendimeve:

- OE kanë bërë vetëm një deklaratë të cilën deklaron se do ti sjellin produktet e kërkuara nga AK të përcaktuara në dosje të tenderit dhe pa dhënë asnjë detaj të vetëm për specifikimet teknike të produkteve dhe përmbajtjes së tyre.
- Nuk ka ofruar fare katalog per produktet e ofruara, nuk ka ofruar shifer te produktit, nuk ka ofruar prodhuesin e produktit si dhe nuk ka ofruar origjinen e mallit te ofruar.
- Ne DT per pozicionin 1 dhe 2 jane kerkuar disa kritere te cilat eshte dashte te plotesohen. Se a jane plotesuar specifikacionet teknike apo jo kjo ka mundur te verehet vetem nese OE kishte prezentuar katalogun e produktit te ofruar.
- Eshte e papranueshme te shpallet nje OE i pergjegjshme nese nuk ka jap detaje se çka eshte duke ofruar, cilat specifika, cilat standarde etj.
- Na nuk dim ndonje AK ne Kosove i cili pranon dhe akcepton nje produkt te ofruar pa pjese katalogut, pa dite se çfar produkti do

te furnizohet, pa e dite se aparati i saldimit a eshte 350 a 351, a eshte 370, a eshte 270 por te akceptohet vetem me nje deklarate. A e ka aparati dorzen ***Mig 500W-5 a eshte teli i perdorshem 0.8-1.2mm ....etjmetj.....***

- Nga çasja ne dokumentacionin e OE tye cilit kane aplikuar ne kete procedure te prokurimit shumica e tyre kane ofruar katalogun per produktet e kerkuara.
- Per me teper se çfar ndodh nese nuk jan dhene specifikacionet teknike nga OE ne Kerkesen per Rivleresim e kemi informuar Autoritetin Kontraktues se jane leshuar shume Vendime te OSHP-se e njera prej tyre qe e sqaron me se miri eshte Vendimi I Organit Shqyrtues te Prokurimit numer **PSH 91/21** te dates 01.03.2021 ku ne mes tjerash eshte thene shprehimisht se "Autoriteti Kontraktues nuk duhet te bazohet ne "Vet -deklarata" te OE te shpallur fitues se i ploteson specifikacionet teknike te detyrueshme per arsye se "Vet-deklarata" nuk eshte prove deshmi.....

Më këto veprime komisioni i vleresimit ka shkelur dispozitat ligjore të Ligjit të Prokurimit Publik lidhur me vlerësimin e pavarur dhe të drejtë e te barabartë. Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga JU qe duke repsektuar LPP kjo lende te kthehet ne Rivleresim ku ankesa e jone te shqyrtohet koform dhe duke repektuar LPP pasi qe ne baze te te gjitha kerkesave te dhena ne njoftimin per kontrate dhe dosjes se tenderi oferta e jone eshte e pergjegjshme ne krahasim me OE te rekomanduar per kontrate dhe te bjen:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e OE ASDEK shpk lidhur me tenderin: "Furnizim me kompresor ajri dhe aparat saldues" me nr. te prokurimit: NPLP-24-2856-1-3-6 nr,brendshem

ANULOHET njoftimi mbi Vendimin e AK per shperblim me kontrate dhe lenda te kthehet ne **RI-VELERESIM .**

RI-VELERESIMI ..- te behet duke u bazuar ne kerkesat e dosjes se tenderit dhe te gjitha dispozitet e LPP qe flasin per menyren e vleresimit te tendereve, ku me pas fitues do te duhej te shpallej kompania ASDEK shpk

Ankeses i bashakngjiten dokumentet:
1.Vendimi ndaj kerkeses per Rishqyrtim
2.Kerkese per Rishqyrtim
3.Njoftimi per Vendimin e AK dhe Letrat Standarde
4.Procesverbali i hajes
5.Dosje e tenderit
6.Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Kompania ASDEK shpk , me plotesimin e te gjitha kerkesave/kushteve te tenderit ka interes te caktuar materialo-juridik ne parashtrimin e Ankeses dhe ka qene nje nga Ofertuesit potencial per fitimin e kontrates publike ngase ka plotesuar te gjitha kerkesat teknike dhe kriteret e Autoritetit Kontraktues dhe ka pasur oferte te pergjegjeshme .
Prandaj, mos vleresimi i drejte dhe ligjor, ashtu sic kerkohet sipas nenit 59 te Ligjit te Prokurimit Publik dhe mos fitimi potencial i nje kontrate publike ne menyre te rregullte ndikon ne shpenzime ligjore, humbje te fitimit real nga mos realizimi i projektit, si dhe reputacioni i Kompanise sone ne tregun konkurrues te Kosoves.
PROPOZIM
Duke u nisur nga prezentimi i argumenteve ligjore me arsyetim ligjor ne Ankese, Kompania ASDEK shpk kerkon nga Paneli Shqyrtues i Organit Shqyrtues te Prokurimit te beje shoshitjen e fakteve ne menyre ligjore duke marre Vendim per te kthyer lenden e kontestuar ne RI-VLERESIM te OFERTAVE, ne menyre qe Autoriteti Kontraktues –te beje vleresim te serishem te ofertave me anetar te rinj te komsionit vleresues dhe te shpall fitues Kompanine ASDEK shpk , qe ka plotesuar te gjitha kushtet, kerkesat dhe kriteret e Autoritetit Kontraktues te potencuara ne Dosje te Tenderit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë: